



GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA
SUPREME COURT OF REPUBLIC OF KOSOVO



Agj.nr. _____

577/2016
10. 09. 2016

Date: 29.09.2016

Kolegjiumi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në Mbledhjen e Përgjithshme, në bazë të nenit 22 të Ligjit për Gjykatat e Rregullta, më 29.09.2016, miratoi këtë:

MENDIMI JURIDIK

Me goditjen me dorë (*grusht ose shuplakë*) mund të kryhet vepra penale sulm nga neni 187.1 të KPK-së, por jo edhe nga neni 187.par.2 të KPK-së.

Arsyetim

Gjykata Themelore në Pejë, me parashitresën e datës 22.03.2016, nga kjo gjykatë ka kërkuar mendim juridik lidhur me paqartësitë për veprimin inkriminues të veprës penale sulm nga neni 187 të KPK.

Sipas kërkesës, ekziston numër i madh i lëndëve në të cilat vepra penale sulm nga neni 187 .KPK-së, kryhet në goditje me grusht apo shuplakë dhe paqartësia është në faktin se ky veprim a mund të konsiderohet si element i kësaj vepre penale.

Goditja me grusht apo shuplakë nënkupton përdorimin e forcës, andaj, mund të jetë veprim i kryerjes së kësaj vepre penale, por me kusht se të dëmtuarit nuk i është shkaktuar lëndim trupor, sepse atëherë do të kishim të bëjnë me veprën penale të lëndimit të rëndë apo të lehtë trupor.

Megjithatë, kur është fjala të paragrafi 2. i nenit 187 goditja me grusht apo me shuplakë nuk mund të jetë veprim i kryerjes së kësaj vepre penale, sepse në kuptim të këtij neni dhe të dispozitës së nenit 188 par. 2 të KPK-së, dora (grushti apo shuplaka) ose pjesa e trupit të njeriut, në përgjithësi, nuk mund të konsiderohet “armë, mjet i rrezikshëm apo send tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor apo dëmtim të rëndë të shëndetit “*përyshtrimisht nëse bëhet fjalë për kryesin që posedon shkathtësi profesionale marciale*”.

(Mendim juridik i miratuar në seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme, i mbajtur më 29.09.2016)